



**Thirrje publike për ofertim – Zhvillimi i 2 produksioneve audio/video për materializimin vizual të aktiviteteve në kuadër të projektit “Angazhimi i diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri”**

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare fton kompanitë e produksioneve multimediale të ofertojnë për produksionin e 2 audio/videove të cilat do të materializojnë vizualisht zbatimin e projektit “Angazhimi i diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri” i cili financohet nga IOM Albania në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve të Italisë (AIC).

Me anë të këtij projekti Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare synon të mundësojë transferimin eficient të njohurive avangard në bujqësi të diasporës shqiptare, kryesisht asaj në Itali, drejt sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme bujqësore në Shqipëri të zonave rurale të Kavajës, Durrësit dhe Përmetit. Aktivitetet e projektit që do të pasqyrohen vizualisht janë trajnime teorike dhe praktike të fermerëve, demonstrime në terren, takime të shpeshta online midis bizneseve B2B dhe promovim i produkteve bujqësore.

**Shërbimi i kërkuar:**

Nga kompania ofertuese kërkohet vizualizimi i përmbajtjes së aktiviteteve në bashkëpunim të ngushtë me Dhomën e Biznesit të Diasporës dhe specifikisht kërkohet:

1. Video prodhim - xhirime, toni/zëri, montazhi, ndriçimi, dizenjimet e videos (ALL/min)
2. Audio lexim/narracion – inçizim
3. Insertimi i titrave në gjuhën shqipe

**Kushtet për Shërbimin:**

Pas nënshkrimit të kontratës, ofruesi i shërbimeve pritet që:

1. Të jetë në gjendje t’i respektojë me përpikmëri afatet kohore për prodhimet audio/video/dizajn.
2. Të jetë në gjendje që të punojë shpejtë dhe të dorëzojë video/audio/dizajn të cilësisë së lartë HD.
3. Të jetë i hapur për rishikime dhe përmirësime përgjatë procesit të produksionit.

**Për t’u kualifikuar, kompania duhet:**

- Të jetë e regjistruar si subjekt ekonomik në Republikën e Shqipërisë
- Të ofrojë dëshmi të përvojës, referencave dhe portofolit të punëve të mëparshme të audio/video produksioneve/dizajnit.

**Kriteret e pjesëmarrjes:**

Të gjitha kompanitë e interesuara duhet të depozitojnë dokumentacionin e kërkuar në adresën: [info@adbc.al](mailto:info@adbc.al) deri në dt. 23 prill 2021, ora lokale 16:00.

Profilin e kompanisë dhe portofolin

Dokumente ligjore që vërtetojnë se kompania është entitet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Oferta financiare/çmimi duhet të bëhet për njësi ALL/min video produksion me TVSH.